



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

RREGULLORE (QRK) – Nr. 37/2024
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË
KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË
FAMILJE, DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE
DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT KOORDINUES NDËRMINISTROR¹

¹ Rregullore (QRK) – Nr. 37/2024 për Organizimin dhe Funkcionimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore dhe Funkcionimin e Grupit Koordinues Ndërmnistror, është miratuar në Mbledhjen e 241-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.03/241, të datës 27.12.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 13 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (GZ, Nr. 22; 12.10.2023), dhe nenit 8, paragrafit 4, nën paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Miratton:

RREGULLORE (QRK) – Nr. 37/2024 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE, DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NE BAZA GJINORE DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT KOORDINUES NDËRMINISTROR

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë, organizimi dhe funksionimi i Zyrës së Koordinatorit/es Kombëtar/e për mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore si dhe funksionimi i Grupit Koordinues Ndërministror.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga të punësuarit në Zyrën e Koordinatorit/es Kombëtar/e për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore dhe Grupi Koordinues Ndërministror.

Neni 3 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me kuptimin e dhënë në Ligjin përkatës për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore.

Neni 4
Zyra e Koordinatorit/es Kombëtar/e

1. Zyra e Koordinatorit/es Kombëtar/e vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Zyra e Koordinatorit/es Kombëtar/e funksionon si Sekretariat i Koordinatorit/es Kombëtar/e kundër Dhunës në Familje në kuadër të Departamentit për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit.

Neni 5
Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Koordinatorit/es Kombëtar/e

1. Zyra e Koordinatorit/es Kombëtar/e ofron mbështetje në:
 - 1.1. hartimin e legjislacionit për qasje në drejtësi, përfshirë mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore;
 - 1.2. hartimin e strategjisë, koncept dokumenteve dhe dokumenteve të tjera të politikave për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore;
 - 1.3. monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore;
 - 1.4. koordinimin, bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje;
 - 1.5. organizimin e fushatave vetëdijësuese për parandalimin e dhunës;
 - 1.6. bashkërendimin e punës së Koordinatorit/es Kombëtar/e me institucionet e tjera si dhe organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore;
 - 1.7. mbledhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore nga institucionet e tjera me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të të dhënave;
 - 1.8. planifikimin buxhetor për Koordinatorin Kombëtar;
 - 1.9. menaxhimin e bazës së të dhënave përkatëse për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, si dhe përgatit dhe paraqet raporte periodike për Koordinatorin/en Kombëtar/e dhe Grupin Koordinues Ndërinstitucional;

1.10. mbledhjen e të dhënave dhe përgatit raporte periodike për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Planin e Veprimit;

1.11. kryen punë të tjera sipas kërkesës së Koordinatorit/es Kombëtar/e.

Neni 6 **Grupi Koordinues Ndërministror**

1. Grupi Koordinues Ndërministror përbëhet nga:

1.1. Zyra e Kryeministrit - Agjencia për Barazi Gjinore, zëvendëskryesues;

1.2. Ministria përgjegjëse për punët e brendshme, anëtar;

1.3. Ministria përgjegjëse për financa punë dhe transfere, anëtar;

1.4. Ministria përgjegjëse për Drejtësi, anëtar;

1.5. Ministria përgjegjëse për shëndetësi, anëtar;

1.6. Ministria përgjegjëse për arsim, anëtar;

1.7. Ministria përgjegjëse për pushtetin lokal, anëtar;

1.8. Ministria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport, anëtar;

1.9. Policia e Kosovës, anëtar;

1.10. Prokuroria e Shtetit, anëtar;

1.11. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar;

1.12. Akademia e Drejtësisë, anëtar;

1.13. Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës, anëtar;

1.14. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, anëtar, dhe

1.15. Përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale, anëtar.

2. Grupi Koordinues Ndërministror kryesohet nga Koordinatorin/ja Kombëtar/e.

3. Anëtarë të përhershëm si përfaqësues të ministrive janë zëvendës ministrat përgjegjës. Në pamundësi të pjesëmarrjes, mund të delegojnë anëtarësinë në një zyrtar të kabinetit përgjegjës.

4. Me ftesën e Kryesuesit/Koordinatorës Kombëtare, mund të ftohen edhe përfaqësues të ministrive të tjera dhe institucioneve të tjera relevante, varësisht nga detyrimet që dalin nga Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve strategjikë në cilësinë e vëzhguesve.

Neni 7 Takimet

1. Grupi Koordinues Ndërmintor mban takime së paku një herë në tre (3) muaj.
2. Grupi Koordinues Ndërmintor në takim vendos për kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbajtjes së takimit të ardhshëm.
3. Takimin mund ta iniciojnë tre (3) apo më shumë anëtarë të Grupit Koordinues Ndërmintor.
4. Në raste të veçanta, Koordinatori/ja Kombëtar/e mund të thërret takimin e Grupit Koordinues Ndërmintor.
5. Koordinatori/ja Kombëtar/e njofton me shkrim së paku pesë (5) ditë pune më herët anëtarët e Grupit Koordinues Ndërmintor për kohën dhe vendin e mbajtjes së takimeve, përveç rasteve të jashtëzakonshme.
6. Rendi i ditës miratohet me shumicën e anëtarëve të pranishëm në takim.
7. Pas miratimit të rendit të ditës, miratohet procesverbali i takimit paraprak.

Neni 8 Procesverbali i takimit

1. Për çdo takim të Grupit Koordinues Ndërmintor mbahet procesverbal, i cili miratohet në takimin e radhës nga Grupi.
2. Procesverbali mbahet nga Sekretaria mbështetëse, respektivisht Zyra e Koordinatorit/es Kombëtar/e.
3. Në procesverbal bëhet një përmbledhje e diskutimit, ceket data dhe vendi i takimit, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan dhe konkluzionet e takimit.
4. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga Koordinatori Kombëtar dhe Procesmbajtësi.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

27 dhjetor 2024